



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 13357 Prot.

Fier më 21.../11/2025

PROJEKT VENDIM

NR. 106 dt. 21.../11/2025

“Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesës e cila ka mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratës para noterit”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt.../11/2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria Juridike, mbi kërkesave zyrtare të familjeve që kërkojnë përfundimin e procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, (ish ZVRPP Fier) për shkak të lidhjes së kontratës të privatizimit para noterit.

Dokumentacioni ligjor i privatizimit është vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier në formën e kërkuar ligjore fotokopje enjehsuar me origjinalin ,dokumentacion i cili administrohet në arkivën pranë kësaj drejtorie.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 97 datë 03.02.2008 " Për procedurat e privatizimit të banesave shtetërore objekt i ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992 dhe ligjit nr. 9321 date 25.1 1.2004 "Per trajtimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e Shoqërive dhe Ndërmarrjeve Shtetërore " dispozitave ligjore nenet 192,193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjin Nr.111/2018“Për Kadastrën”, ekzekutivi propozon :

Propozon

1.Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të apartamenteve, përkatesisht lidhjen e kontratës të shitblerjes para Noterit, të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për familjen si më poshtë:

Nr.	Emër-Mbiemer	Pasuria / Adresa
1	Xhevit Veli Memlikaj	Kartela e Pasurisë së paluajtshme /Fragment I Hartës Kadastrale Nr.i Pasurisë 41/1+4-8 lloji “Apartament “ ZK Nr.3038 ,përbërje 1+1 , sip.52.4 m2
2	Aristir Rrapi Jano	Kartela e Pasurisë së paluajtshme /Fragment I Hartës Kadastrale Nr.iPasurisë72/3+2-9 lloji “Apartament“ ZK Nr.3301,përbërje 1+1 , sip.48.3 m2

2. Shpenzimet noteriale dhe tarifat për veprimet e regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore , do të kryhen nga familja përfituese.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier, ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës para noterit publik.

KRYETAR
Armando Subashi

